

Në institucionin e Avokatit të Popullit kanë bërë ankesë shtetasit nga B.M.; M.H.; M.A. dhe Sh.M., të cilët janë përfaqësuar nga avokate N.V., anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Sipas ankuesve, ata kanë qenë të detyruar që të largohen nga vendi i tyre dhe të hyjnë në mënyrë të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë (RSH). Pasi kanë kaluar kufirin e RSH-së, këta shtetas të huaj janë kapur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kufitare Sarandë dhe marrë në pyetje. Në vijim të kryerjes së veprimeve, nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë ndaj tyre është vendosur dëbimi nga territori i RSH-së sipas renditjes së bërë më sipër respektivisht me urdhrat nr. 800, datë 25.05.2022; nr. 801, datë 25.05.2022; nr. 802, datë 25.05.2022 dhe nr. 803, datë 25.05.2022, si dhe ndalimi në Qendrën e Mbyllur për të Huajt (QMH) Karreç respektivisht me urdhrat nr. 800/1, datë 25.05.2022; nr. 801/1 datë 25.05.2022; nr. 802/1, datë 25.05.2022 dhe nr. 803/1, datë 25.05.2022.

Sipas ankuesve, nga informacioni që disponojnë rezulton se ata po mbahen në QMH Karreç në cilësinë e dëshmitarit pasi dyshohet se janë trafikuar nga persona të tjerë për të cilët organi i Prokurorisë Sarandë ka filluar një procedim penal dhe po zhvillon hetime. Gjithashtu atyre u është komunikuar se duhet të mbahen në këtë qendër për arsye se marrja e deklarimeve të tyre duhet të bëhet në prezencë të një përkthyesi të gjuhës së tyre amtare i cili nuk po gjendej ende.

Ndërkohë ankuesit pretendojnë se privimi i lirisë së tyre duke i vendosur në QMH Karreç në cilësinë e dëshmitarit është në kundërshtim me ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt”, në të cilin nuk parashikohet mbyllja e personave të huaj të parregullt në territorin e RSH-së nga organi i prokurorisë, si dhe për shkak të marrjes së dëshmisë së tyre. Gjithashtu ata i referohen nenit 102/7 të këtij ligji ku parashikohet se, *të huajt i komunikohet në formë të shkruar, në gjuhën që kupton ose, së paku, në gjuhën angleze...*

Përveç sa më sipër, nga verifikimet e bëra nga ana jonë të dokumentacionit të administruar nga QMH Karreç lidhur me këta shtetas konstatoam se ndodhej edhe një urdher “Për transferimin e shtetasve të huaj” në QMH Karreç dhe shkresa përcjellëse e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë nr. 821/5 prot. /I.H., datë 25.05.2022, dërguar këtij institucioni.

Nga përmbajtja e urdhrat të cituar më sipër rezulton se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë është regjistruar procedimi penal nr. 281, i vitit 2022, në ngarkim të shtetasit T.D. për veprën penale “Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufijve”, kryer nëpërmjet përdorimit të mjeteve të transportit, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal. Në kuadër të dokumentimit të faktit penal për të cilin bën fjalë ky procedim penal rezulton e domosdoshme jo vetëm identifikimi me gjeneralitete të plota të shtetasve B.M.; M.H.; M.A. dhe Sh.M., origjina e tyre, si dhe marrja e deklarimeve të nevojshme mbi faktin penal objekt hetimi. Sipas prokurorit të kësaj çështjeje, në këto rrethana del e nevojshme

vijimi i qëndrimit në territorin e RSH-së të këtyre shtetasve dhe për këto arsye është urdhëruar transferimi i tyre në QMH Karreç.

Gjithashtu në pikën 3 të këtij urdhri parashikohet se qëndrimi i tyre në këtë qendër do të zgjasë deri në një urdhërim të dytë nga prokurori i çështjes së procedimit penal nr. 281, të vitit 2022.

Nga QMH Karreç u informuam se, urdhrat e dëbimit të këtyre shtetasve të nxjerra nga DVKM Vlorë përcaktojnë largimin e tyre nga territori i RSH-së jo më vonë se 10 ditë nga data e njoftimit. Ndërkohë nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë është dërguar urdhri me shkresën nr. 821/5, datë 25.05.2022 për mbajtjen e tyre në këtë qendër deri në një urdhërim të dytë nga prokurori i çështjes. Ndoshtur në këto rrethana, QMH Karreç në datën 01.06.2022 i ka dërguar një shkresë organit të prokurorisë nëpërmjet të cilës i kërkon informacion nëse duhet të mbahen ende në këtë institucion këta shtetas për nevojat e hetimit të procedimit penal nr. 281, të vitit 2022.

Për të vijuar me shqyrtimin e kësaj ankese iu drejtua me kërkesë për informacion Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM) Vlorë të cilës i kërkuam informacion lidhur me sa më poshtë vijon:

1. Cilat janë shkaqet dhe baza ligjore e nxjerrjes nga ky organ të urdhrave të dëbimit dhe ndalimit për 4 shtetasit nga Bangladeshi B.M.; M.H.; M.A. dhe Sh.M.?
2. A qëndrojnë pretendimet e ankuesve se ndalimi i tyre në QMH Karreç nga DVKM Vlorë është bërë në bazë të një shkrese/urdhri të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, me qëllim marrjen e dëshmisë së tyre?
3. Nëse po, cila është baza ligjore e kryerjes së këtij veprimi/nxjerrjes së akteve administrative nga ana juaj?

Drejtorja Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë me shkresën nr. 1872/1 prot., datë 08.09.2022 na informoi se, në datën 22.05.2022, rreth orës 16:40, nga patrulla e Seksionit ZMPKT dhe Stacionit të Policisë Kufitare Qafëbotë, në afërsi të fshatit Çiflig, janë konstatuar 4 shtetas të huaj të parregullt dhe pa dokumente të cilët po transportoheshin nga shtetasi T.D. nga fshati Gjashtë Sarandë me mjetin veturë me targa "RGA 989". Nga patrulla e shërbimit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit T.D. si i dyshuar për veprën penale "Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufijve", parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal dhe shoqërimi i tyre për veprime të mëtejshme në Komisarriatin e Policisë Sarandë. Në komisarriat me këta persona ka punuar Seksioni i Trafikeve, i cili ka kryer procedurat përkatëse për veprën penale të përshkruar më sipër.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me shkresën nr. 821/5 prot., datë 25.05.2022, u kërkuar që për efekt të vazhdimit të hetimeve të mëtejshme, shtetasit e

huaj të mbahen në QMH Karreç. Procedura e përzgjedhjes dhe regjistrimet janë kryer nga Zyra e Migracionit të Komisarariatit të Policisë Kufitare Sarandë.

Nga intervistimi në Zyrën e Shërbimit të Migracionit, rezultoi se shtetasit e huaj ishin nga Bangladeshi dhe kishin hyrë në territorin e RSH-së në mënyrë të paligjshme nëpërmjet kufirit të gjelbër afër PKK Qafëbotë në datën 22.05.2022 dhe pasi kanë udhëtuar në këmbë janë konstatuar nga shërbimet e Policisë Kufitare në afërsi të fshatit Çiflig duke u transportuar nga shtetasi T.D.. Ata kanë deklaruar se kishin si qëllim të shkonin drejt vendeve të Bashkimit Evropian (BE) për punë.

Bazuar në nenin 102/1/a dhe nenin 115 të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, ndaj shtetasve të huaj B.M.; M.H.; M.A. dhe Sh.M. është vendosur dëbimi nga territori i RSH-së me urdhrat sipas renditjes së tyre të bërë më sipër respektivisht nr. 800, datë 25.05.2022; nr. 801, datë 25.05.2022; nr. 802, datë 25.05.2022 dhe nr. 803, datë 25.05.2022, si dhe ndalimi në QMH Karreç respektivisht me urdhrat nr. 800/1, datë 25.05.2022; nr. 801/1 datë 25.05.2022; nr. 802/1, datë 25.05.2022 dhe nr. 803/1, datë 25.05.2022.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me shkresën nr. 821/12 prot., I/H, datë 05.07.2022 është njoftuar se kanë përfunduar veprimet hetimore ndaj shtetasve të huaj të sipërpërmendur.

Bazuar në nenin 99/1/a të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt” është bërë konvertimi i urdhrave të dëbimit dhe shfuqizimi i urdhrave të ndalimit për shtetasit:

1. J.M., u konvertua urdhri i dëbimit nr. 801, datë 25.05.2022, me urdhër largimi nr. 801/2, datë 19.07.2022, dhe shfuqizimi i urdhrat të ndalimit në QMH Karreç nr. 801/1, ndalim hyrje në territor deri në datën 25.05.2027;
2. M.H., u konvertua urdhri i dëbimit nr. 800, datë 25.05.2022, me urdhër largimi nr. 800/3, datë 19.07.2022, dhe shfuqizimi i urdhrat të ndalimit në QMH Karreç nr. 800/1, ndalim hyrje në territor deri në datën 25.05.2027;
3. M.A., u konvertua urdhri i dëbimit nr. 802, datë 25.05.2022, me urdhër largimi nr. 802/2, datë 19.07.2022, dhe shfuqizimi i urdhrat të ndalimit në QMH Karreç nr. 802/1, ndalim hyrje në territor deri në datën 25.05.2027;
4. Sh.M., u konvertua urdhri i dëbimit nr. 803, datë 25.05.2022, me urdhër largimi nr. 803/2, datë 19.07.2022, dhe shfuqizimi i urdhrat të ndalimit në QMH Karreç nr. 803/1, ndalim hyrje në territor deri në datën 25.05.2027.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se nga QMH Karreç, u kryen veprimet përkatëse dhe se shtetasit e huaj nuk kanë paraqitur pretendime.

Ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me shkresën nr. 841/14 prot./I.H., datë 12.09.2022 na informoi se ky organ ka në hetim procedimin penal nr. 281, të vitit 2022, regjistruar në ngarkim të shtetasit T.D. për veprën penale “Ndhurma për kalimin e paligjshëm të kufijve”, kryer nëpërmjet përdorimit të mjeteve të transportit, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal.

Nga tërësia e hetimeve të zhvilluara deri më tani rezulton:

“Në datën 22.05.2022, rreth orës 16:40, në brendësi të fshatit Çiflig, Bashkia Konispol, efektivet e Komisarariatit të Policisë Kufitare dhe Migracionit Sarandë, kanë ndaluar mjetin e markës “Kia”, me targa të huaja “RGA 989”, të drejtuar nga shtetasi T.D. në të cilin janë gjetur shtetasit e vetëdeklaruar si shtetas të Republikës Popullore të Bangladeshit B.M.; M.H.; M.A. dhe Sh.M..

Në vlerësimin paraprak të rrethanave të faktit të ndodhur, kanë rezultuar dyshime për ekzistencën e veprës penale “Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal. Bazuar në këto dyshime, në datën 22.05.2022, ora 23:59 oficeri i policisë gjyqësore ka kryer arrestimin në flagrancë të shtetasit T.D., ndaj të cilit, bazuar në kërkesën e prokurorit, Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë, nëpërmjet vendimit nr. 23-2022-870, datë 25.05.2022, ka caktuar masën e sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, masë e cila vazhdon të jetë në zbatim.

Në fazën fillestare të këtij procedimi, në kushtet kur shtetasit e huaj nuk kishin njohuri në ndonjë gjuhë që mundësohej marrja e deklarimeve të tyre; duke vlerësuar se për shtetasit e huaj “*autoriteti përgjegjës mund të urdhërojë dëbimin e tyre nga territori i Republikës së Shqipërisë*”, duke vlerësuar se “*në kuadër të dokumentimit të faktit penal për të cilën bën fjalë ky procedim penal rezulton e domosdoshme jo vetëm identifikimi me gjeneralitete të plota të shtetasve në fjalë si dhe origjina e tyre, por gjithashtu edhe marrja e deklarimeve të nevojshme mbi faktin penal objekt hetimi*”; si dhe duke vlerësuar gjithashtu se deklarimet e shtetasve të huaj do të përbënin prova të rëndësishme për fatin e hetimeve, ku largimi i mundshëm i tyre nga territori i Republikës së Shqipërisë do ta bënte pothuajse të pamundur marrjen e deklarimeve të çdonjërit prej tyre, nëpërmjet aktit procedural “*urdhër për transferimin e shtetasve të huaj*”, të datës 25.05.2022, prokurori ka kërkuar “*transferimin e shtetasve ... pranë Qendrës së Mbyllur për Huajt Karreç, Durrës*”, urdhërim ky i zbatuar nga strukturat e Policisë së Shtetit. (Sqarojmë se një kopje e këtij urdhri na u dërgua së bashku me përgjigjen).

Në vijim të kësaj përgjigjeje u informuam se, sapo ka administruar deklarimet e çdonjërit prej shtetasve të huaj, nëpërmjet shkresës nr. 821/12, prot., datë 05.07.2022, prokurori ka njoftuar QMH Karreç se, “*nga ana e organit të akuzës janë administruar deklarimet e çdonjërit prej të lartpërmendurve ... në vijim organi i akuzës nuk ka ndonjë interes karshi shtetasve të huaj... pasi ... vlerësojmë se tashmë nuk është e nevojshme prania e ndonjërit nga shtetasit e huaj të evidentuar më sipër për kryerjen e veprimeve hetimore me të. Ndaj çdonjëri prej tyre mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme në zbatim të urdhër dëbimit të marrë karshi tij*”. (Sqarojmë se gjithashtu një kopje e kësaj shkrese na u dërgua bashkëlidhur me përgjigjen).

Po ashtu, organi i prokurorisë rikonfirmon faktin se përpos faktit se mbajtja e çdonjërit prej shtetasve të huaj pranë QMH Karreç është kryer në zbatim të masës administrative të marrë nga organi kompetent policor, kërkimi për mbajtjen e tyre pranë këtij institucioni

është realizuar edhe në bazë të urdhërimit të prokurorit, si një domosdoshmëri për administrimin e provave që do të mundësonin provimin e faktit penal që i atribuohet shtetasit shqiptar T.D..

Në përfundim të këtij informacioni organi i prokurorisë shprehet se, ju informojmë gjithashtu se në bazë të deklarimeve të marra çdonjërit prej shtetasve të huaj, fakti penal objekt hetimi tashmë përfaqësohet nga bashkëpunimi i shtetasit T.D. me shtetas të tjerë ende të paidentifikuar, veprimtaria e të cilëve është realizuar kryesisht në territorin e Republikës së Greqisë, duke passjellë një ndryshim në cilësimin juridik të regjistrimit të veprës penale.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, i materialeve të administruara dhe përgjigjeve të ardhura nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Vlorë, si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë konstatojmë se:

1. Shtetasit e huaj B.M.; M.H.; M.A. dhe Sh.M., të vetëdeklaruar si shtetas të Republikës Popullore të Bangladeshit, kanë hyrë në territorin e RSH-së në mënyrë të parregullt dhe me qëllim për të shkuar në vendet e BE-së për punë. Në bazë të nenit 102/1/a të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”¹, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë ka nxjerrë urdhër dëbimi për secilin prej tyre nga territori i RSH-së dhe ndalimin për të hyrë në territorin e RSH-së me afat 5 vjeçar. Në vlerësimin tonë, ky veprim është korrekt dhe i bazuar në ligj.

2. Ndalimi i këtyre shtetasve në QMH Karreç nuk është bërë në përputhje me nenin 115/1 të ligjit nr. 79/2021². Sipas këtij neni, ndalimi në qendrën e mbyllur të një shtetasi të huaj

¹ Neni 102 “Dëbimi i të huajt”, parashikon se:

1. Dëbimi i të huajt nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin është një masë administrative, e cila ndërmerret për largimin e të huajt nga territori shqiptar në bazë të vlerësimeve, rast pas rasti, kur rezultojnë se i huaji:

a) ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka të dhëna se do të përdorë territorin e saj për të kaluar ilegalisht drejt vendeve të tjera;

² Neni 115 “Ndalimi në qendër të mbyllur”, parashikon se:

1. Ndalimi në qendrën e mbyllur është masa e fundit administrative që merret dhe ekzekutohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal për trajtimin e të huajve ndaj të huajt për të cilin është nxjerrë një urdhër dëbimi, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë ekzekutuar të gjitha masat e mundshme alternative, ose kur nga vlerësimi konsiderohet se këto masa nuk mund të zbatohen për të huajin, ose për të huajin e ripranuar, në bazë të marrëveshjeve të ripranimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me qëllim të vetëm sigurimin e kushteve për kthimin/ripranimin e tij.

2. I huaji mbahet i ndaluar në qendër të mbyllur, të ngritur posaçërisht për këtë qëllim, në afate sa më të shkurtra kohore, derisa të kryhen procedurat ligjore, për të mundësuar largimin e tij nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal për trajtimin e të huajve mund ta ndalojë në qendër të mbyllur për arsye të sigurisë publike të huajin, identiteti apo arsyet e qëndrimit të të cilit nuk janë të qarta.

të parregullt në RSH-së është masa e fundit administrative që merret dhe ekzekutohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal për trajtimin e të huajve për të cilin është nxjerrë një urdhër dëbimi, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë ekzekutuar të gjitha masat e mundshme alternative.

Por, në rastin e marrë në shqyrtim nuk rezulton që ndaj shtetasve të huaj të sipërpërmendur të jenë dhënë dhe ekzekutuar masa të tjera alternative sikurse parashikohet në Seksionin IV të këtij ligji, respektivisht në nenet 109, 110, 111, 112 e 113, të cilat janë: *Detyrimi për t'u paraqitur në intervale të rregullta kohore pranë autoriteteve përgjegjëse rajonale për kufirin dhe migracionin; Bllokimi i biletës ose i dokumentit të udhëtimit; Bllokimi i mjeteve financiare ose vendosja e garancisë financiare; Qëndrimi i detyrueshëm në një territor të caktuar.*

3. Mbyllja e ankuesve në QMH Karreç është bërë nën ndikimin e organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë dhe respektivisht me urdhrin “Për transferimin e shtetasve të huaj” në QMH Karreç dhe shkresës përcjellëse të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë nr. 821/5 prot./I.H., datë 25.05.2022, dërguar QMH Karreç dhe për dijeni Komisarariatit të Policisë Kufitare Sarandë. Nëse DVKM Vlorë do të kishte vendosur mbylljen e tyre në QMH Karreç, do të kishte vepruar që ditën e parë apo maksimumi në ditën e dytë pas kapjes së tyre. Në fakt, sikurse rezulton edhe nga dokumentet e administruara në këtë rast, urdhrat e dëbimit dhe urdhrat e mbylljes së tyre në QMH Karreç, janë bërë pas tre ditësh dhe pikërisht pas dërgimit të urdhrat dhe shkresës përcjellëse të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

Nga përmbajtja e këtij urdhri rezulton se nxjerrja e tij është bazuar në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale (KPrP) dhe në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”. Nga referimi i bërë në nenin 24 të KPrP rezulton se në funksionet e prokurorit nuk është parashikuar nxjerrja e një urdhri të tillë për mbylljen e shtetasve të huaj në QMH Karreç me qëllim për t'u marrë deklaratime në cilësinë e dëshmitarëve. Ndërsa ligji nr. 108/2013 “Për të huajt” është shfuqizuar me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 79/2021 “Për të huajt”. Pavarësisht referimit të gabuar të numrit të ligjit “Për të huajt”, në fakt jo vetëm në ligjin e mëparshëm “Për të huajt”, të referuar nga organi i prokurorisë si bazë ligjore, por as në ligjin e ri “Për të huajt”, i cili është në fuqi aktualisht, nuk parashikohet kompetenca lëndore e prokurorit për të nxjerrë urdhra për mbylljen e shtetasve të huaj në QMH Karreç, qofshin ata edhe të parregullt në RSH apo dëshmitarë të një fakti apo veprë penale, sikurse ka ndodhur në rastin në fjalë.

Sikurse është parashikuar në nenin 114 të ligjit nr. 79/2021, *Qendra e mbyllur është një institucion administrativ, me nivel të caktuar sigurie dhe kufizim lirie, në të cilin mund të*

4. I huaji njoftohet në formë të shkruar, në gjuhën që kupton ose së paku në gjuhën angleze, për urdhrin e ndalimit në qendër të mbyllur, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën që të sigurojë mbrojtje ligjore me një avokat të zgjedhur prej tij ose kryesisht, si dhe të kontaktojë me të afërmit e vet.

vendosen vetëm të huajt që janë subjekt dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë. Pra, kjo qendër është quasi burg dhe për këtë arsye, mbyllja e të huajve në këtë qendër duhet të bëhet mbi bazën e një vlerësimi rast pas rasti dhe jo për çdo shtetas të huaj të parregullt në vendin tonë dhe me qëllim realizimin e urdhrave të dëbimit të nxjerrë ndaj tyre, por jo, kurrsesi ndaj dëshmitarëve, sikurse është vepruar në rastin në fjalë.

Ne vlerësojmë se në këtë rast dhe meqënëse organi i prokurorisë kishte interes për zbardhjen e hetimit të procedimit penal nr. 281, të vitit 2022, të filluar ndaj shtetasit T.D., ai mund të shpejtonte veprimet procedurale për marrjen e dëshmive të shtetasve të huaj në prani të një përkthyesi në gjuhën që ata kuptojnë ose së paku në gjuhën angleze gjatë tre ditëve që ankuesit ndodheshin në Komisaratin e Policisë Kufitare Sarandë. Po ashtu, nga struktura vendore për kufirin dhe migracionin ndaj këtyre shtetasve mund të ishin aplikuar masat e tjera alternative të parashikuara në nenet 110, 111, 112 e 113 të ligjit “Për të huajt” të cilat i përshkruam më sipër dhe jo mbyllja në QMH Karreç.

4. Gjithashtu u konstatua se urdhrat e dëbimit të këtyre shtetasve të nxjerra nga DVKM Vlorë përcaktojnë largimin e tyre nga territori i RSH-së jo më vonë se 10 ditë nga data e njoftimit. Ndërkohë që ata janë mbajtur në QMH Karreç deri në datën 19.07.2022, pra reth 1 muaj e dy javë tej afatit të përcaktuar në urdhrat e dëbimit.

5. Përveç sa më sipër nga shqyrtimi i kësaj ankese rezulton se, ankuesit e huaj janë kapur në datën 22.05.2022 dhe janë sjellë në QMH Karreç në datën 25.05.2022 (e provuar kjo me aktin e dorëzimit të tyre nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kufitare Sarandë në QMH Karreç). Pra, nga momenti i kapjes dhe deri në datën e mbylljes së tyre në QMH Karreç kanë kaluar gati tre ditë. Në vlerësimin tonë, kjo kohë ka qenë e mjaftueshme për të kryer veprimet procedurale me këta shtetas nga organi i prokurorisë. Ndërkohë nga DVKM Vlorë nuk na është dërguar informacion se ku janë mbajtur ata gjatë kësaj kohe dhe si janë trajtuar për t’u plotësuar nevojat jetike të paktën me ushqim e ujë.

Është rasti që të sjellim në vëmendje se shtetasit e huaj që hyjnë në mënyrë të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë për të shkuar drejt vendeve të Bashkimit Evropian për punë apo azil janë një kategori vulnerabël. Gjatë viteve të fundit në territorin e vendit tonë kanë hyrë me qëllim kalim në vendet e BE-së një numër jo i vogël/i konsiderueshëm shtetasish nga vende të ndryshme, kryesisht nga Azia, të cilët largohen për shkak të varfërisë së tejskajshme, luftrave që i kanë përfshirë këto vende, etj. Ata krahas problematikave të tjera, mund të jenë të traumatizuar nga ngjarjet e rënda që kanë ndodhur në këto shoqëri apo në familjet e tyre. Ndodhur në këto rrethana, dhe shpesh herë pa të ardhura financiare e veshmbathje të nevojshme, duke lëvizur në këmbë e në terrene të vështira, të kequshqyer e pa gjumë dhe për më tepër kur nuk njohin as gjuhën tonë, ata meritojnë një përkujdesje të shtuar humane, veçanërisht nga strukturat shtetërore. Por pavarësisht kësaj, strukturat shtetërore kanë detyrimin ligjor që të respektojnë të gjitha të drejtat ligjore që atyre u garantohet nga Kushtetuta e RSh-së, Konventat Ndërkombëtare dhe aktet e tjera normative ligjore e nënligjore në fuqi në vendin tonë.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, si dhe në nenin 21/c të këtij ligji, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të analizuar këtë rast dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.
2. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e punonjësve të Policisë Kufitare dhe Migracionit me qëllim zbatimin me korrektësi, profesionalizëm dhe objektivitet të dispozitave të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, lidhur me rastet e mbylljes së shtetasve të huaj të parregullt në QMH Karreç. Të theksohet e sillet në vëmendje se kjo masë duhet të jetë e fundit dhe të bëhet mbi bazën e një vlerësimi rast pas rasti dhe pasi të jenë aplikuar masat e tjera alternative të parashikuara në këtë ligj.
3. Marrjen e masave të nevojshme organizative nga strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit në shkallë vendi me qëllim kryerjen e veprimeve të shpejta me shtetasit e huaj, duke siguruar domosdoshmërisht praninë e një përkthyesi në gjuhën që ata kuptojnë ose së paku në gjuhën angleze, dhe në rastet kur ata pyeten si persona ndaj të cilëve zhvillohen hetime edhe në prani të avokatit mbrojtës.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga Prokuroria e Përgjithshme, për nxjerrjen e një udhëzimi/qarkoreje për unifikimin e praktikës nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë lidhur me procedimet për veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufijve”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, apo të veprave të tjera penale ku janë të përfshirë në rolin e autorit apo dëshmitarit edhe shtetas të huaj. Të theksohet se, në të tilla raste lind nevoja e marrjes së masave për të siguruar përkthyes në gjuhët që ata kuptojnë ose së paku në gjuhën angleze si dhe të avokatëve, me qëllim kryerjen e veprimeve të shpejta për të provuar faktet penale në ngarkim të autorëve të dyshuar të kësaj vepre penale dhe pa cënuar garancitë e të drejtat ligjore të tyre.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi lutemi të na njoftoni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca